

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA	
ZYRA E Kryeministrit - UREDI Premijera - OFFICE OF THE PRIME MINISTER	
SEKTORI I Arkivës - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. lista Öre: Org. Unit	02.1.a
Nr. Proje: Proje Nr.	1019
Nr. fletëve: Br. stranic No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	12 / 06 / 2023
Prishtinë/a	



Datë: 12.06.2023

Mbledhja e përbashkët ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbahet më 14 qershor 2023, në orën 10:00, në Gjakovë.

RENDI I DITËS

1. Hapja e mbledhjes dhe fjala e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Sh. T. Albin Kurti, pasuar nga fjala e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Sh. T. Edi Rama.
2. Diskutim në lidhje me Bashkëpunimin për Realizimin e Bashkimit Doganor ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës.
3. Deklaratë e përbashkët për Forcimin e Bashkëpunimit në Fushën e Sigurisë në mes Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.
4. Memorandum për Bashkëpunim për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit në mes Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.
5. Marrëveshje për Bashkëpunim në Lehtësimin e Procedurave në Pikat e Inspektimit Kufitar për Produktet me Origjinë jo Shtazore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
6. Marrëveshje për bashkëpunim në fushën fitosanitare ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural të Kosovës.
7. Marrëveshje në Fushën e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
8. Marrëveshje për Bashkëpunim për Realizimin e Olimpiadës së Përbashkët në Lëndën e Gjuhës Shqipe për Klasat e 9-ta, në Arsimin Parauniversitar ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

9. Marrëveshje për Shkëmbimin e Përvojave Lidhur me Pjesëmarrjen në Vlerësimet Ndërkombëtare të Nxënësve dhe Zhvillimin Profesional të Mësuesve ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
10. Marrëveshje për Njohjen e së Drejtës së Ushtimit të Profesioneve të Avokatit dhe Ndërmjetësit në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.
11. Memorandum për Bashkëpunim për Ofrimin e Shërbimeve Shëndetësore ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës.
12. Marrëveshje për bashkëpunim në fushën e teatrit ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë, dhe Sportit të Republikës së Kosovës.
13. Memorandum për Bashkëpunim në Fushën e Zhvillimit të Sipërmarrjes dhe Konkureshmërisë të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) dhe Startup-eve ndërmjet Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të Republikës së Kosovës.
14. Marrëveshje Teknike për Bashkëpunim në Fushën e Mjekësisë Ushtarake ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës.
15. Memorandum për Bashkëpunim për Lehtësimin e Procedurave të transitit të kalimit të mallrave ushtarake për qëllime dhe nevoja të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës.
16. Marrëveshje për përdorimin e platformës digjitale E-inspection ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të mbledhjes, zhvillohet ceremonia solemne e nënshkrimit të marrëveshjeve në mes dy qeverive.